



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr.463, datë 19.10.2020

PËR
KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË EMËRIMIT NË GJYKATËN E APELIT
TIRANË, PËR TRE POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE DHE
PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 181, NR. 183 DHE NR. 184, DATË
28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja, znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, (në fushën e të drejtës civile), për pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe (në fushën e të drejtës penale), për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 184, datë 28.05.2020.
2. Vendimi nr. 310, datë 10.09.2020, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR